REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 6493/9 Prot. Sarandë, më 06.08.2026

PROÇESVERBAL

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Sarandë që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:00
Data e mbajtjes së mbledhjes :04.08.2026
Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak
Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Sarandë: Zv/Kryetar Manjola Cikuli dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen.

Marrin pjesë :

1. Asaf Stroka
2. Bejdo Çela
3. Ermir Hoxha
4. Ilirjan Gërdhuqi
5. Dritan Peçi
6. Laureta Çeçi
7. Denisa Islamaj
8. Dafina Allkushi
9. Shpëtim Ahmeti
10. Gjergji Imeraj
11. Edlira Gjidede
12. Lindita Kondi
13. Zana Piro
14. Xhino Jaçaj
15. Festim Mina
16. Ilva Qëndro
17. Elona Mano
18. Farie Hyska
19. Katerina Beqo

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SEKRETARIA E KËSHILLIT
BASHKIA SARANDË

Mungojnë :

20. Ibrahim Bajrami
21. Vesel Koçiu
22. Përparim Ahmeti
23. Klejdjan Murtaj
24. Anjeza Dike
25. Angjele Lapa
26. Pranvera Osmani
27. Enea Vasili
28. Indi Rrapaj
29. Thanas Gurma
30. Eugen Qëndro
31. Kevin Alikaj

Asaf Stroka : Përshëndetje !
Të nderuar Anëtarë të Këshillit Bashkiak!I nderuar Zv/Kryetar i Bashkisë!Të nderuar pjesëmarrës dhe përfaqësues të medias !
Zhvillojmë mbedhjen e Këshillit Bashkiak datë 04.08.2026, vijojmë bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, çdo fillim mbledhje miratohet rendi i ditës sipas thirrjes për zhvillimin e mbledhjes sipas rendit si më poshtë:

1. Informacion nga Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Sarandë mbi situatën e furnizimit me ujë, problematikat aktuale, masat e ndërmarra për garantimin e furnizimit të rregullt me ujë për qytetarët.

2. **P/vendim**"Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin qershor 2026".

3. **P/vendim**"Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin qershor 2026".

4. **P/vendim**"Për miratimin e ndihmës financiare për shtetasin Robert Çela ".

5. **P/vendim**"Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Sarandë të pasurisë me nr.8/157 "truall" me sipërfaqe prej 6441 m^2 dhe "ndërtesë" me sipërfaqe prej 1145.21 m^2 , zona kadastrale 8642 Sarandë".

6. **P/vendim**"Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Sarandë të pasurisë me nr. 2/66 dhe 2/196 "truall" me sipërfaqe prej 2549 m^2 zona kadastrale 8642 Sarandë".

7. **P/vendim** " Për një ndryshim në buxhetin e Bashkisë Sarandë për vitin 2026".

8. **P/vendim**"Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Sarandë të pasurisë me nr. 11/354, 11/375,11/356 ,11/358 dhe nr.11/387 me sipërfaqe totale 1978.4 m^2 prej, zona kadastrale 8641 Sarandë".

9. **P/vendim**"Për miratimin e nisjes së procedurës dhe miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit për pasuritë pronë private, që preken nga projekti "përmirësimi i infrastrukturës së zonës periferike Sarandë".

Gjergji Imeraj: Propozoj një pikë shtesë në rendin e ditës, nga administrata e Bashkisë na ka ardhur ky projektvendim.
P/vendim "Për miratimin e nisjes së procedurës dhe miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit për pasuritë pronë private, që preken nga projekti "Rikualifikimi i rrugëve të brendshme, zona "Turizëm - Kanali Çukës, faza I".

Ilir Gërdhuqi: Propozoj të shtohet në rendin e ditës një pikë për problemin e parkimeve.

Shpëtim Ahmeti: Propozimin e bërë nga zoti Gërdhuqi e mbështetëm, për arsye se dhe me largimin që u bë të gjitha mjeteve të rënda, autobusë, furgona në terminal. Sot parkimet në Sarandë janë në kaos, duket sikur janë bërë biznes privat, prandaj duhet një raport i detajuar për të gjitha parkimet.

Asaf Stroka: Hedhim në votim rendin e ditës me propozimin e bërë nga z. Imeraj dhe propozimin e bërë nga z. Gërdhuqi.

Pas diskutimeve, u vendos të kalojnë në pikën 10 dhe 11 dy propozimet e bëra.
Miratohet me 19 vota pro rendi i ditës.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e parë të rendit të ditës: Informacion nga Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Sarandë mbi situatën e furnizimit me ujë, problematikat aktuale, masat e ndërmarra për garantimin e furnizimit të rregullt me ujë për qytetarët.

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 1 të rendit të ditës, kemi në sallë Laert Iliazi, drejtorin teknik të shoqërisë rajonale. Kush ka pyetje?

Shpëtim Ahmeti: Në Sarandë kemi 32 vjet pa ujë, s'kemi gjë me drejtorin, por me Bashkinë, me politikat e PS, me drejtuesin e qarkut. Ka 15 vjet Partia Socialiste që e drejton bashkinë dhe vazhdojmë të jemi pa ujë. Në Ksamil s'ka fare ujë në kulmin e sezonit, nuk ka ç'të bëjë drejtori, duhet të bëhen investime aty ku duhen.
Pse s'ka ujë Gjashta dhe pse s'ka ujë Ksamili?

Laureta Çeçi:

1. Cila zonë ka pasur ndërprerjet më të shpeshta dhe për çfarë arsyesh në rrjet?
2. Sa është përqindja e humbjes së ujit në rrjet?
3. Sa ankesa janë depozituar nga banorët e Sarandës?

Edlira Gjidede:

1. A ka Bashkia një plan afatshkurtër apo afatgjatë për furnizimin me ujë?
2. Sa investime janë kryer gjatë vitit 2026 dhe sa rezultat kanë pasur?

Laert Iliazi: Sistemi i furnizimit funksionon sipas parametrave teknikë, duke garantuar furnizimin e banorëve dhe vizitorëve në përputhje me kërkesat e sezonit veror.
Gjithashtu, është në proces kolaudimi rrjeti i ri i ujësjellësit në zonën e Gjashtës, i cili pritet të përmirësojë ndjeshëm cilësinë dhe vazhdimësinë e furnizimit me ujë për banorët e kësaj zone. Burimet ujore, stacionet e pompimit, rezervuarët dhe rrjeti shpërndarës monitorohen në mënyrë të vazhdueshme, 24 orë në 24.
Në Sarandë problemet i kemi në lagjen Kodër, ku kemi mungesë presioni.
Masat e marra për përballimin e fluksit:
Monitorim i vazhdueshëm i burimeve ujore, depove dhe rrjetit shpërndarës. Organizim i shërbimit teknik me gatishmëri 24 orë për ndërhyrje në raste avarie.
Mirëmbajtje e stacioneve të pompimit dhe linjave të transmetimit.
Gjatë kësaj periudhe, janë evidentuar disa problematika, të cilat janë menaxhuar nga strukturat teknike: Janë shfaqur disa defekte në linjën e transmetimit nga puset e Vrionit, të cilat janë riparuar në kohë.
Dëmtimi i linjës së transmetimit të ujit të pijshëm nga puset e Çukës, si pasojë e një aksidenti automobilistik, krijoi vështirësi për furnizimin me ujë të zonës së Ksamilit. Si pasojë e stuhisë së disa ditëve më parë dhe ndërprerjeve të energjisë elektrike, që ndikuan në funksionimin e stacioneve të pompimit, është krijuar një situatë e përkohshme me vështirësi në furnizimin me ujë në disa zona të Bashkisë Sarandë dhe zonën e Ksamili për një periudhë rreth dyditore. Rritja e konsumit gjatë sezonit turistik ka sjellë ngarkesë të shtuar mbi sistemin e furnizimit, veçanërisht gjatë orëve të pikut. Në segmente të caktuara të rrjetit vazhdojnë të evidentohen humbje teknike për shkak të amortizimit të infrastrukturës.
Në lidhje me pyetjet sa është përqindja e humbjes së ujit në rrjet, sa ankesa janë depozituar nga banorët e Sarandës, nuk mund të përgjigjem sot, më duhet të dërgoj informacion me shkrim.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e dytë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin qershor 2026".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 2 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?
Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 19 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e tretë të rendit të ditës: **P/vendim** "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin qershor 2026".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 3 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.
Miratohet me 19 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e katërt të rendit të ditës: **P/vendim** "Për miratimin e ndihmës financiare për shtetasin Robert Çela".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 4 të rendit të ditës, kemi ndonjë pyetje nga ana e këshilltarëve?
Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 19 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e pestë të rendit të ditës**: P/vendim** "Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Sarandë të pasurisë me nr. 8/157 "truall", me sipërfaqe prej 6441 m² dhe "ndërtesë", me sipërfaqe prej 1145.21 m², zona kadastrale 8642 Sarandë".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 5 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Gjergji Imeraj: Ku ndodhet objekti?

Garufo Koka: Prona e cila është objekt i këtij projektvendimi është shkolla "Hasan Tahsini". Është trualli dhe ndërtesa. Ky projektvendim vjen përpara jush në kuadër të të gjithë procedurave që Bashkia Sarandë po kryen lidhur me asetet e saj publike, për të formalizuar regjistrimin përfundimtar pranë ASHK dhe pajisjen e tyre me certifikatën përkatëse, që në këtë rast është shkolla "Hasan Tahsini". Kemi gjithashtu dhe shkollën "Baba Rexhep", pra, ne kemi përfshirë të gjitha asetet tona për të përmbyllur këtë proces të rëndësishëm për asetet e Bashkisë.

Shpëtim Ahmeti: Projektvendimet në vazhdimësi, që nga "Baba Rexhepi" e në vazhdim, e shoh që do t'ju vijë fundi si Eco Campusi. Ne jemi pro investimeve në arsim, por dua të di: a ka një projekt konkret në lidhje me një parkim në ambientet e shkollës, i cili me siguri do t'u jepet oligarkëve?

Garufo Koka: Ju keni miratuar ndryshimin e buxhetit, ku është bërë një ndarje e re lidhur me investimet. Është paraqitur përpara jush një projektide lidhur me një parkim publik, i cili parashikohet të bëhet në pjesën e pasme të këtij territori, me qëllim përdorimin sa më eficient të të gjithë aseteve publike, sepse nuk ka hapësira të mjaftueshme për parkim në qytet. Aty ekziston hapësira dhe është një projektide për parkim publik, i cili do të administrohet nga Bashkia Sarandë.

Ilir Gërdhuqi: Në mbledhjen e komisionit kam kërkuar të më vendoset në dispozicion projekti konkret dhe nuk shikoj asnjë lloj serioziteti, nuk ka ardhur. Duke qenë se administrata dhe drejtoritë përkatëse nuk janë serioze, unë do ta bojkotoj mbledhjen.

Largohen nga salla këshilltarët:
Shpëtim Ahmeti
Ilirjan Gërdhuqi
Edlira Gjidede

Mbeten në sallë 16 këshilltarë

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 13 vota pro, abstenim 1, kundër 2.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Sarandë të pasurisë me nr. 2/66 dhe 2/196 "truall" me sipërfaqe prej 2549 m^2 zona kadastrale 8642 Sarandë".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 6 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka diskutime

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 14 vota pro, abstenim 0, kundër 2.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për një ndryshim në buxhetin e Bashkisë Sarandë për vitin 2026".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 7 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka diskutime

Miratohet me 14 vota pro, abstenim 0, kundër 2.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e tetë të rendit të ditës:**P/vendim** "Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Sarandë të pasurisë me nr. 11/354, 11/375,11/356 ,11/358 dhe nr.11/387 me sipërfaqe totale 1978.4 m^2 prej, zona kadastrale 8641 Sarandë".

Asaf Stroka:Për sa i përket pikës 8 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka diskutime

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohen me 13 vota pro, abstenim 0, kundër 3.
Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës: **P/vendim**"Për miratimin e nisjes së procedurës dhe miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit për pasuritë pronë private, që preken nga projekti "përmirësimi i infrastrukturës së zonës periferike Sarandë".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 9 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente diskutime

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 13 vota pro, abstenim 0, kundër 3.

Largohet nga salla këshilltarët
Laureta Çeçi
Farie Hyska

Asaf Stroka : Duke ju falenderuar, e deklaroj mbledhjen të mbyllur.

Ky proçesverbal mbyllet me nr.rendor 7(shtatë) fletë, i cili pasi verifikohet firmoset nga kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe komisioni i verifikimit të procesverbalit.

Mbajtësi i proçesverbalit: Valbona Vasili

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :

1.	Kryetar i Këshillit Bashkiak :	Asaf Stroka
2.	Partia Socialiste e Shqipërisë:	Lindita Kondi
3.	Partia,Drejtësi,Integrim dhe Unitet:	Klejdjan Murtaj
4.	Partia Balli Kombëtar:	Bejdo Çela
5.	Partia Republikane Shqiptare :	Përparim Ahmeti
6.	Fryma e Re Demokratike:	Ilir Gërdhuqi
7.	Kryetar i Grupit Bashkë Fitojmë:	Shpëtim Ahmeti
8.	Kryetar i Grupit Partia Demokratike:	Vesel Koçiu
9.	Aleanca Arbnore Kombëtare:	Xhino Jaçaj
10.	I pavarur	Kevin Alikaj